



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: data: 06.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.01.2025, të parashtruar nga “Qendra Për Trajtimin E Kafshëve SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Trajtimi i qenëve endacak- Ritenderim” me Nr. të Prok: 613-24-13372-2-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e oë “Qendra Për Trajtimin E Kafshëve SH.P.K.”, të dt. 03.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qenëve endacak- Ritenderim”, me nr. të Prok: 613-24-13372-2-2-1.

Vërtetohet Njoftimi për kontratë i Autoritetit Kontraktues dhe dosja e tenderit.
Mbetet në fuqi Njoftimi për kontratë i Autoritetit Kontraktues dhe dosja e tenderit:
19.12.2024.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

“Qendra Për Trajtimin E Kafshëve SH.P.K.”, me datë 03.01.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qenëve endacak- Ritenderim”, me nr. të Prok: 613-24-13372-2-2-1 ku këtë aktivitet AK ka publikuar Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi me datë 19.12.2024.

“Qendra Për Trajtimin E Kafshëve SH.P.K.”, me datë 03.01.2025 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Trajtimi i qenëve endacak- Ritenderim”

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë duke vendosur si ne Dispozitiv.


AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit